



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04-21914882 me 10 NOV 2023

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 11, paragrafi 6 të Ligjit nr.04/L-106 për Teatrot dt.24.05.2011, Kryetari i Kryeqytetit merr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** Vendimi për emërimin e Këshillit Drejtues të Teatrit " Dodona" në Prishtinë.
- II. Anëtarët e Këshillit Drejtues të cekur në piken I të këtij vendimi, janë:
  - 1.Melihate Qena , aktore;
  - 2.Adil Olluri, letrar dramaturg;
  - 3.Arta Arifi, dramaturge;
  - 4.Agron Gërguri, anëtar;
  - 5.Lindita Hajdari, udhëheqëse në Drejtorinë e Kulturës .
- III. Detyrë e Këshillit Drejtues të cekur në piken II të këtij Vendimi janë : Të mbikëqyrë punën e teatrit, aprovon politikat afatgjata të zhvillimit të teatrit dhe politiken artistike , me propozim të drejtorit të përgjithshëm miraton planin vjetor buxhetor të teatrit, me propozim të udhëheqësit artistik dhe në përputhje me buxhetin vjetor miraton programin artistik vjetor të teatrit, shqyrton dhe miraton raportin vjetor, financiar të teatrit, harton dhe propozon statutin, rregulloret dhe aktet tjera nënligjorë të teatrit, të cilat i miraton asambleja komunale, interviston kandidatet dhe zgjedhë drejtorin e përgjithshëm dhe udhëheqësin artistik, inicon procedurën dhe shkarkon drejtorin e përgjithshëm dhe udhëheqësin artistik, si dhe merr vendime me shumicë absolute të votave të të gjithë anëtarëve.
- IV. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues si në piken II të këtij Vendimi është katër (4) vjeçar.
- V. Për kryerjen e detyrave si në piken III të këtij vendimi, Këshillit Drejtues i raporton Kryetarit të Kryeqytetit.
- VI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me nr. 14-020/02-0110311/18 dt.10.05.2018.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

**I DORËZOHET :**

- Drejtorisë për Kulturë;
- Anëtarëve të Këshillit Drejtues;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT  
Përparim Rama

